anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2		3	4	5
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njesia	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)
1	Kategoria I – me risk të lartë, sipas Termave të References, Shtojca 8	Komplet	232		
2	Kategoria II – me risk të ulët, sipas Termave të References, Shtojca 8	Komplet	153		
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

“Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”, sipas Termave të References.

Afatet e ekzekutimit: 12 (dymbëdhjete) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

1	“Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”,			12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës
---	--	--	--	---

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

“Sigurimi i jetës dhe shëndetit për punonjësit e OST sh.a.”

QËLLIMI I SHËRBIMIT

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST sh.a.), duke vlerësuar rëndësinë e shëndetit dhe jetës së punonjësve të vet, si dhe duke vlerësuar minimizimin e riskut financiar, ka vendosur të vazhdojë të mundësojë sigurimin e jetës dhe shëndetit, për kategorinë e punonjësve të ekspozuar në mënyrë më të madhe ndaj rreziqeve, siç është kategoria e punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes së linjave, kategoria e punonjësve të sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve si dhe për punonjëset femra të OST sh.a., me qëllim parandalimin e sëmundjeve të ndryshme.

Termat e referencës kanë për qëllim përcaktimin e nevojave që shoqëria përcakton për punonjësit.

OBJEKTI I SHËRBIMIT

Sigurimi i jetës dhe shëndetit në punë, për punonjësit e sektorit të mirëmbajtjes së linjave, për punonjësit e sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve, dhe punonjëset femra, për një periudhë 1 (një) vjeçare duke konsideruar përfitimet:

1. Përfitimet për sigurim jete nga aksidentet personale në punë;
2. Përfitimet për sigurim shëndetësor;

PUNONJËSIT DHE MBULIMI I SIGURIMIT

Nisur nga struktura organizative miratuar me Vendimin nr. 10, datë 21.12.2021 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Operative dhe Njesisë së Mirëmbajtje Transmetimit”, ndryshuar me Vendimin Nr.6, datë 18/07/2024 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a numri i planifikuar i punonjësve të Sektorit të Mirëmbajtjes së Linjave paraqitet si më poshtë:

Njësia	Nr.faktik sipas strukturës /Sektori i Mirëmbajtjes së Linjave
NJOT	21 remonter
NJMT	27 remonter + 13 manovrator
NJOB	21 remonter
NJOF	31 remonter
NJOK	13 remonter
NJOE	9 remonter
NJOSH	31 remonter

TOTALI	166 punonjës të sektorit të mirëmbajtjes së linjave
---------------	--

Nisur nga struktura organizative miratuar me Vendimin nr. 10, datë 21.12.2021 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Operative dhe Njesisë së Mirëmbajtje Transmetimit” ndryshuar me Vendimin Nr.6, datë 18/07/2024 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a, numri faktik i punonjësve të Sektorit të Mirëmbajtjes së Nënstacioneve paraqitet, si më poshtë:

<i>Njësia</i>	<i>Nr.faktik sipas strukturës /Sektorit i Mirëmbajtjes së Nënstacioneve</i>
<i>NJOT</i>	<i>25 remonter</i>
<i>NJMT</i>	<i>0 remonter</i>
<i>NJOB</i>	<i>4 remonter</i>
<i>NJOF</i>	<i>16 remonter</i>
<i>NJOK</i>	<i>3 remonter</i>
<i>NJOE</i>	<i>10 remonter</i>
<i>NJOSH</i>	<i>8 remonter</i>
TOTALI	66 punonjës të sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve

Nisur nga struktura organizative miratuar me Vendimin nr.9, datë 21.12.2021 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a “Për miratimin e strukturës organizative të Aparatit Qendror të OST sh.a.” ndryshuar me Vendimi Nr. 7, datë 18/07/2024 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a; Vendimi nr. 10, datë 21.12.2021 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a “Për miratimin e strukturës organizative të Njësive Operative dhe Njesisë së Mirëmbajtje Transmetimit” ndryshuar me Vendimin Nr.6, datë 18/07/2024 të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a, numri faktik i punonjësve femra paraqitet, si më poshtë:

<i>Njësia</i>	<i>Nr. faktik sipas strukturës</i>
Qendër/Administrata	95 punonjësë
NJMT	4 punonjësë
NJOT	15 punonjësë
NJOK	3 punonjësë
NJOSH	6 punonjësë
NJOF	9 punonjësë

NJOB	3 punonjësë
NJOE	18 punonjësë
TOTALI	153 punonjësë femra

Kategoria I – punonjës me risk të lartë – punonjësit e sektorit të mirëmbajtjes së linjave; punonjësit e sektorit të mirëmbajtjes së nënstacioneve.

Kategoria II – punonjës me risk të ulët – punonjësët femra të Aparatit Qendror, Njësi Operative dhe Njësish të Mirëmbajtje Transmetimit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) do të përcaktojë listën e detajuar të personave që do të përfitojnë sigurimin e jetës dhe shëndetit në punë.

KATEGORIA I

Grafiku i Përfitimeve KATEGORIA 1 (RISK I LARTË)

PËRFITIMET PËR SIGURIM JETE DHE AKSIDENTET PERSONALE	
Shuma e siguruar	deri në 5,000,000 Lekë
Humbje jete natyrore	1,000,000 Lekë
Humbje jete si pasojë e një aksidenti	5,000,000 Lekë
Paaftësi aksidentale	Sipas tabelës së paaftësive
PËRFITIMET PËR SIGURIM SHËNDETËSOR	
Maksimumi Vjetor	2,500,000 Lekë
Pjesa e zbritshme vjetore (në lekë)	0 LEKË
Zona e mbulimit	1. Shqipëri; 2. Europë (përfshijtur Zvicër), në rast se shërbimi mjekësor nuk ofrohet në strukturat mjekësore shtetërore apo private në Shqipëri
Përfitime për Trajtim si Pacient i Shtruar në Spital privat	100%
Akomodim dhe ushqim në spital (dhomë gjysmë-private)	100%

Shpenzimet për pagesën e mjekut specialist, kirurgut, anestezistit	100%
Përdorimi i pajisjeve dhe aparaturave të sallës së operacionit	100%
Ndërhyrje kirurgjikale	100%
Reanimacion, Kujdes Intensiv	100%
Kontrolle diagnostikuese, përfshirë X - Ray, CT Scan, MRI, Pet Scan	100%
Receta mjekësore (Medikamentet e këshilluara nga mjeku dhe fashat) për përdorim në spital, si dhe gjaku, plazma dhe oksigjeni	100%
Kemioterapi dhe Radioterapi (vetëm pas trajtimit si pacient i shtruar)	100%
Proteza dhe pajisje mjekësore të ngjashme	100%
Terapi fizike dhe rehabilitim	100%
Përfitime për Trajtim Ditor (në rast mos shtrimi në Spital)	Deri 200,000 Lekë
Shpenzime për konsultat me mjekun e përgjithshëm dhe mjekun specialist	100%
Kontrolle diagnostikuese me rreze X, skaner CT, skaner MRI apo PET dhe ekzaminime të rekomanduara nga një mjek	100%
Terapi fizike dhe rehabilitim (pas aksidenteve të ndodhura brenda periudhës së sigurimit)	100%
Trajtim infermierik	100%, deri në 50,000 lekë
Kirurgjia ditore (ndërhyrje kirurgjikale pa shtrim)	100%
Fizioterapi e këshilluar nga mjeku specialist	15 seanca në vit, Max. deri në 30,000 Lekë/vit
Receta Mjekësore (medikamente të këshilluar nga mjeku)	100% deri në 100,000 lekë
Të tjera	
Kemioterapi dhe Radioterapi	100%
Shërbimi i ambulancës në rrugë dhe ambulance ajrore në rast rreziku që kërcënon jetën.	100%
Ndërhyrje kirurgjikale në spital shtetëror	50% e vlerës, e së të njëjtin shërbim në spitalet private në Shqipëri
Shpenzime dentare si pasojë e aksidentit	100%, deri në 50,000 lekë
Shërbimet brenda rrjetit mjekësor të Siguruesit	100%
Shërbimet jashtë rrjetit mjekësor të Siguruesit në Shqipëri	90%

Shërbimet jashtë rrjetit mjekësor të Siguruesit jashtë Shqipërisë	70%
Shërbime që kërkojnë autorizim paraprak	Për përfitimet e mëposhtme duhet të merret autorizim paraprak nga Siguruesi: a. Trajtim me shtrim në spital b. Kontrole të imazherisë së avancuar (CT skan, magnetik MRI, Pet Scan) c. Koronarografi d. Kolonoskopi e. Kirurgji pa shtrim në spital f. Kujdes parandalues
Afatet e rimbursimit	15 ditë
Afatet e asistencës me pagesë direkte	5 ditë
Mosha maksimale e marrjes në sigurim për herë të parë	Deri 65 vjeç
Zbritje në çmimet e shërbime mjekësore që nuk mbulohen nga kontrata e sigurimit	20% deri në 50% zbritje

Mbulimi i Gjendjeve Mjekësore Pre-Ekzistuese (Sigurimi i Shëndetit)

Për sëmundjet dhe gjendjet mjekësore të diagnostikuara para fillimit të sigurimit, si dhe sëmundjeve apo dëmtimeve të lidhura me gjendjen para ekzistuese duke përfshirë çdo komplikacion të tyre, do të mbulohen shpenzimet mjekësore për trajtimin e tyre sipas zërave të Grafikut të Përfitimeve deri në vlerën prej 200,000 lekë për person për të gjithë zërat e grafikut të përfitimeve së bashku.

Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular		
A	Humbja e jetës si pasojë aksidentit në punë	100%
B	Paaftësi e Përherëshme	
1	Paaftësi e Plotë e Përherëshme	100%
2	Humbje ose humbje e plotë e përherëshme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3	Humbje ose humbje e plotë e përherëshme e përdorimit të një gjymtyre	75%
4	Humbje e plotë e përherëshme e shikimit në të dy sytë	100%
5	Humbje e plotë e përherëshme e shikimit në një sy	75%
6	Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	100%
7	Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
8	Humbje e përherëshme dhe e pakurueshme e shëndetit mendor	100%
9	Humbje e plotë e përherëshme e dëgjimit	
a)	në të dy veshët	70%
b)	në një vesh	20%

10	Humbje e plotë e të folurës	70%
11	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	50%
	b) të majtë	40%
12	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të katër gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	30%
	b) të majtë	15%
13	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtit të madh të dorës	
	a) të dyja falangat e gishtit të djathtë	30%
	b) një falangë e gishtit të djathtë	15%
	c) të dyja falangat e gishtit të majtë	20%
	d) një falangë e gishtit të majtë	10%
14	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të tjerë	
	a) tre falanga të një gishti të dorës së djathtë	10%
	b) dy falanga të një gishti të dorës së djathtë	7%
	c) një falangë e një gishti të dorës së djathtë	5%
	d) tre falanga të një gishti të dorës së majtë	7%
	e) dy falanga të një gishti të dorës së majtë	5%
	f) një falangë e një gishti të dorës së majtë	3%
15	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës	
	a) të gjithë gishtërinjtë e një këmbë	10%
	b) dy falanga të gishtit të madh të këmbës	5%
	c) një falangë e gishtit të madh të këmbës	3%
	d) secili prej gishtave përveç gishtit të madh	3%
16	Shkurtim i këmbës me të paktën 5 cm	7%
17	Djegje të shkallës së tretë	
Zona:	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 8%	100%
- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 20%	100%
	Paaftësi aksidentale e përkohshme e plotë	2000 Lekë në ditë, për çdo ditë paaftësie (përfshijtur ditët e pushimit)

KATEGORIA II

Grafiku i Përfitimeve KATEGORIA 2 – (RISK I ULËT)

PËRFITIMET PËR SIGURIM JETE DHE AKSIDENTET PERSONALE	
Shuma e siguruar	deri ne 2,000,000 Lekë
Humbje jete natyrore	1,000,000 Lekë
Humbje jete si pasoje e një aksidenti	2,000,000 Lekë
Paaftësi aksidentale	Sipas tabelës se paaftësive
PËRFITIMET PËR SIGURIM SHËNDETËSOR	
Maksimumi Vjetor	2,000,000 Lekë
Pjesa e zbritshme vjetore (në leke)	Nuk do të aplikohet
Zona e mbulimit	Shqipëri
Përfitime për Trajtim si Pacient i Shtruar në Spital privat	100%
Akomodim dhe ushqim në spital (dhomë gjysmë-private)	100%
Shpenzimet për pagesën e mjekut specialist, kirurgut, anestezistit	100%
Përdorimi i pajisjeve dhe aparaturave të sallës së operacionit	100%
Ndërhyrje kirurgjikale	100%
Reanimacion	100%
Kontrolle diagnostikuese, përfshirë X - Ray, CT Scan, MRI, Pet Scan	100%
Ilaçet dhe medikamentet mjekësore për përdorim në spital, si dhe gjaku, plazma dhe oksigjeni	100%
Receta mjekësore (Medikamentet e këshilluara nga mjeku dhe fashat)	100%
Kemioterapi dhe Radioterapi (vetëm pas trajtimit si pacient i shtruar)	100%
Proteza dhe pajisje mjekësore të ngjashme	100%
Terapi fizike dhe rehabilitim	100%
Përfitime për Trajtim Ditor (në rast mos shtrimi në Spital)	Deri 150,000 Lekë
Shpenzime për konsultat me mjekun e përgjithshëm dhe mjekun specialist	100%
Kontrolle diagnostikuese me rreze X, skaner CT, skaner MRI apo PET dhe ekzaminime të rekomanduara nga një	100%

mjek	
Terapi fizike dhe rehabilitim (pas aksidenteve të ndodhura brenda periudhës së sigurimit)	100%
Kirurgjia ditore (ndërhyrje kirurgjikale pa shtrim)	100%
Receta Mjekësore (medikamente të këshilluar nga mjeku)	100%
Kemioterapi dhe Radioterapi	100%
Kujdes dhe kontrolle parandalues në Shqipëri	Sipas listës bashkëlidhur
Të tjera	
Shërbimi i ambulancës në rrugë	100%
Të tjera	
Shërbimi i ambulancës në rrugë	100%
Ndërhyrje kirurgjikale në spital shtetëror	50% e vlerës, e së të njëjtin shërbim në spitalet private në Shqipëri..
Shërbimet brenda rrjetit mjekësor	100%
Shërbimet jashtë rrjetit mjekësor	90%
Shërbime që kërkojnë autorizim paraprak	Për përfitimet e mëposhtme duhet të merret autorizim paraprak nga Siguruesi: a. Trajtim me shtrim në spital b. Kontrolle të imazherisë së avancuar (CT skan, magnetik MRI, Pet Scan) c. Koronarografi d. Kolonoskopi e. Kirurgji pa shtrim në spital f. Kujdes parandalues
Afatet e rimbursimit	15 ditë
Afatet e asistencës me pagesë direkte	5 ditë
Mosha maksimale e marrjes në sigurim për herë të parë	Deri 65 vjeç
Zbritje në çmimet e shërbime mjekësore që nuk mbulohen nga kontrata e sigurimit	20% deri në 50% zbritje
Lista e ekzaminimeve të kujdesit parandalues (kontroll mjekësor i përgjithshëm vjetor)	
Femra	
Gjak komplet	
Sediment	
Urinë komplet	
Glicemi esëll	

TSH, Ft3, Ft4
Lipidograma
Ferritinë
Sgot, Sgpt
Azotemi
Kreatinemia
Bilirubine totale
Ekg
Eko Gjiri ose Mamografi
Pap test
Eko gjinekologjike
Eko abdominale
Vizite Patologu

Këto ekzaminime do të kryhen me frekuencë 1 herë në vit, në një subjekt mjekësor të përcaktuar nga Siguruesi, nga një listë spitalësh ose klinikash të njohura për reputacionin dhe cilësinë e shërbimeve mjekësore.

Mbulimi i Gjendjeve Mjekësore Pre-Ekzistuese (Sigurimi i Shëndetit)

Për sëmundjet dhe gjendjet mjekësore të diagnostikuara para fillimit të sigurimit, si dhe sëmundjeve apo dëmtimeve të lidhura me gjendjen para ekzistuese duke përfshirë çdo komplikacion të tyre, do të mbulohen shpenzimet mjekësore për trajtimin e tyre sipas zërave të Grafikut të Përfitimeve deri në vlerën prej 200,000 lekë për person për të gjithë zërat e grafikut të përfitimeve së bashku.

	Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular	
A	Humbja e jetës si pasojë aksidentit në punë	100%
B	Paaftësi e Përherëshme	
1	Paaftësi e Plotë e Përherëshme	100%
2	Humbje ose humbje e plotë e përherëshme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3	Humbje ose humbje e plotë e përherëshme e përdorimit të një gjymtyre	75%
4	Humbje e plotë e përherëshme e shikimit në të dy sytë	100%
5	Humbje e plotë e përherëshme e shikimit në një sy	75%
6	Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe	100%

	humbja e shikimit në një sy	
7	Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
8	Humbje e përhershme dhe e pakurueshme e shëndetit mendor	100%
9	Humbje e plotë e përhershme e dëgjimit	
	a) në të dy veshët	70%
	b) në një vesh	20%
10	Humbje e plotë e të folurës	70%
11	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	50%
	b) të majtë	40%
12	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të katër gishtërinjve të dorës	
	a) të djathtë	30%
	b) të majtë	15%
13	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtit të madh të dorës	
	a) të dyja falangat e gishtit të djathtë	30%
	b) një falangë e gishtit të djathtë	15%
	c) të dyja falangat e gishtit të majtë	20%
	d) një falangë e gishtit të majtë	10%
14	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të tjerë	
	a) tre falanga të një gishti të dorës së djathtë	10%
	b) dy falanga të një gishti të dorës së djathtë	7%
	c) një falangë e një gishti të dorës së djathtë	5%
	d) tre falanga të një gishti të dorës së majtë	7%
	e) dy falanga të një gishti të dorës së majtë	5%
	f) një falangë e një gishti të dorës së majtë	3%
15	Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës	
	a) të gjithë gishtërinjët e një këmbë	10%
	b) dy falanga të gishtit të madh të këmbës	5%
	c) një falangë e gishtit të madh të këmbës	3%
	d) secili prej gishtave përveç gishtit të madh	3%
16	Shkurtim i këmbës me të paktën 5 cm	7%
17	Djegje të shkallës së tretë	
Zona:	Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
- koka	e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 8%	100%
- trupi	e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	25%
	e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	40%
	e barabartë ose më e madhe se 20%	100%
	Paaftësi aksidentale e përkohshme e plote	0.15% e shumës së sigurimit të aksidenteve, për

		çdo ditë paaftësie, jo më shumë se 2000 Lekë në ditë
--	--	--

PJESËMARRJA DHE KUALIFIKIMI

- a) Kompania e sigurimit të jetë e licensuar nga AMF për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasën 2 – Sigurimi i Sëmundjeve dhe/ose klasa 19 -Sigurimi i jetës;
- b) Të ofrojë mbulimin për shërbimin spitalor, me garanci pagese;
- c) Të paraqesë metodën që aplikon çdo i siguruar për gjurmimin e kërkesave për rimbursim në mënyrë që personi i siguruar të ketë transparencë të procesit të rimbursimit;
- d) Në procedurën e rimbursimit kompania e sigurimit mjaftohet vetëm me paraqitjen e kopjes së dokumentacionit të analizave/ekzaminimeve të kryera nga i siguruari me qëllim përfitimin e rimbursimit. Dokumentacioni origjinal i analizave/ekzaminimeve të kryera i mbeten të sigurvearit.
- e) Të paraqesë procedurën e organizimit të shërbimit pa pagesë kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;
- f) Të paraqesë procedurën e rimbursimit të shërbimit kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;
- g) Në rast emergjence të sigurvearit nuk duhet t’i refuzohet shërbimi në rrjetin mjekësor të Sigurvearit, me paraqitjen e kartës së sigurimit. Në raste jo emergjente shërbimi me garanci pagese nga Sigurveari ofrohet pasi është dakorduar midis të sigurvearit dhe sigurvearit.

Shenim:

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku është cituar standard nderkombetar, do të pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkuar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Pikes 1 të kësaj shtojce.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 38,000,000 (tridhjetë e tetë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e siperpërmendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 7,000,000 (shtatë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues, ne perputhje me Ligjin Nr. 52, date 22.05.2014 “Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit”, duhet te jete i licencuar nga AMF (Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare) per ushtrimin e veprimtarise ne klasen 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasen 2 – Sigurimi i Semundjeve dhe/ose klasa 19 - Sigurimi i jetës. Per te permbushur kete kriter, OE ofertues duhet te paraqese licencen me kategorite perkatese.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese nje vetedeklarim, ku te specifikojë se merr persiper dhe pranon, si me poshte vijon:

- a) Kompania e sigurimit të jetë e licensuar nga AMF për ushtrimin e veprimtarisë në klasën 1 – Sigurimi i Aksidenteve, klasën 2 – Sigurimi i Sëmundjeve dhe/ose klasa 19 -Sigurimi i jetës.
- b) Të ofrojë mbulimin për shërbimin spitalor, me garanci pagese (pa paguar i siguruari)
- c) Të paraqesë metodën që aplikon cdo i siguruar për gjurmimin e kërkesave për rimbursim në mënyrë që personi i siguruar të ketë transparencë të procesit të rimbursimit
- d) Të paraqesë procedurën e organizimit të shërbimit pa pagesë kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;
- e) Të paraqesë procedurën e rimbursimit të shërbimit kur shërbimi mjekësor merret jashtë Shqipërisë;
- f) Ne rast emergjence te siguruarit nuk duhet te refuzohet shërbimi ne rrjetin mjekësor te Siguruesit, me paraqitjen e kartes se sigurimit. Ne raste jo emergjente shërbimi me garanci pagese nga Siguruesi ofrohet pasi eshte dakorduar midis te siguruarit dhe siguruesit.

2.3.4 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Ames, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
